

**AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR " VOYAGER " shpk**

Ortakët e shoqërisë "VOYAGER" shpk janë si më poshtë:

I. Z. Olgers Shurdhi , i lindur në Berat, në datë 28.06.1996 dhe banues në adresën: Tirane, Rruga Irfan Tomini, i identifikuar me ID nr. J60628060I, lëshuar në datë 04.10.2012, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (Ortak I vetëm), shpreh dëshirën sipas kërkesave të ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" QKR , per krijimin e shoqerise me te dhenat e meposhtme:

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur: " VOYAGER " shpk. Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës I lind e drejta të ushtrisë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKB). Shoqëria " VOYAGER " shpk zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

" VOYAGER " shpk ka selinë e saj në: Tirane, Rruga e Dibres, Nderresa 110, Njesi Bashkiake Nr.8.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutores dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 3

Shoqëria do të ushtrisë aktivitetin në fushën e shërbimit:

Menaxhim dhe marketing i medias sociale, ofrimi i shërbimeve të publicitetit dhe marketingut. Promovim i produkteve online, produkteve të teknologjisë së informacionit si website dhe aplikacione web. Promovim i shërbimeve të hotelerisë, turistike, dentare dhe shëndetësore. Krijimi, mirëmbajtja, menaxhimi i faqeve të internetit për të tretë, përfshirë shoqëri tregtare vendase dhe të huaja. Si dhe çdo veprimtari tjetër të përcaktuar nga ligji

Per te gjithe aktivitetet per ushtrimin e te cilave kerkohet licensee posacme, shoqeria do te ushtrije aktivitetin pasi me pare te jete pajisur me licensen perkatese nga organet kopetente.

Neni 4

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë "VOYAGER" shpk do të jetë 1000 lekë (një mijë) lekë, me kontributet e ortakut të vetëm:

Z. Olgers Shurdhi, i cili zoteron 1 kuote ose 100 % të gjithë kapitalit të shoqërisë

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në lekë
Z. Olgers Shurdhi	100%	1	1000 Leke

Neni 5

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrë ortakut. Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vertetua ra, në dokumentat financiare rezultojnë me i vogël se gjysma e kapitalit themelues, ortakut vendos brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktuara këtu humbje mbi mundësinë e prishjes së parakoheshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezervë.

Neni 6

Ortakut i vetëm mund t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, teresisht apo pjesërisht të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qoftë edhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Ortaku i Vetëm
- Administratori

Afati i emerimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërsëritje, në bazë të nenit 95 të Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic është përcaktuar në statut.

Procedura për emerimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

Neni 8

Administratori i shoqërisë . Olgers Shurdhi, i lindur në Berat, në datë 28.06.1996 dhe banues në adresën: Tirane, Rruga Irfan Tomini i identifikuar me ID nr. J60628060I,, shtetas Shqiptar. Dhe me afatin i tij në shoqëri do të jetë 5 vjet.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori do të ketë tagrin të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo persona të tjerë të autorizuar nënkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim. Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është i autorizuar të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si dhe ka të drejtë të delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti I shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 9

Vendimet e ortakut te vetem mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

Neni 10

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, nese shoqeria do të ketë llogaritet e saj rrjedhese. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i ortakut te vetem. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

Neni 11

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ortakut te vetem ne perpjestim me kontribut:in ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jene hequr 5 % qe dote futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

Neni 12

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 13

Ortaku i vetem eshte i detyruar te ruaje karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer, te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

Neni 14


Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptin, dote paraqiten per zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 15

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur ne te vullnetin e lire te tij. Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne organet kompetente, tatimore, ne zyren e noterise, si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
(Njëkohësisht dhe administrator I shoqërisë)

Z. Olgers Shurdhi



Tiranë, më 01 Nentor 2022